



## VENDIM I ASAMBLESE SË ORTAKËVE I SHOQËRISE "MEDIA 6" SHPK

Sot më datë 28.03.2000 u mbledh në Tiranë, në Rr. Dervish Hima, ADA Tower, kati i dytë, asambleja e ortakëve të Shoqërisë "Media 6" sh.p.k.

"Media 6" Shpk është regjistruar si person juridik me vendim të gjykatës së Rrethit Tirane me nr. 16941 date 12.Shkurt 1997. Administrator i kësaj shoqërie është Z. Aleksandër Frangaj. Kohëzgjatja e veprimtarisë është 10 vjet dhe objekti i veprimtarisë është ajo në fushën e mediave. Ortakët e shoqërisë së mësipërme janë:

- Julien Roche zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Marsel Skende zotërues i 25% (njëzetepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- Aleksandër Frangaj zotërues i 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Merr drejtimin e mbledhjes Z. Aleksandër Frangaj i cili konstaton se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë ortakët e shoqërisë dhe e deklaroi mbledhjen të hapur për të diskutuar mbi pikat e rendit të ditës për të cilat kanë marre me parë njoftim ortakët:

1. Ndryshimi i formës së shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime;
2. Paraqitja e kërkesës pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë për caktimin e një eksperti kontabël të autorizuar për të vlerësuar pasurinë e kësaj shoqërie që përbën dhe aktivin e saj.
3. Të tjera.

1. **NDRYSHIMI I FORMËS SË SHOQËRISË NGA SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR NË SHOQËRI ANONIME;**

Z. Aleksander Frangaj vuri në dijeni ortakët e tjerë se me daljen e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Shoqëria "Media 6" e cila ka si objekt të saj të veprimtarisë ekskluzivisht atë të mediave duhej të ndryshonte formën e saj në bazë të kërkesave të nenit 20 të këtij ligji. Pra kjo shoqëri duhej të ndryshonte formën e saj nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.

Pas një diskutimi të hollësishëm ortakët me unanimitet vendosën:


**Ndryshimin e formës së shoqërisë "Media 6" nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri anonime.**



2 PARAQITJA E KËRKESËS PRANË GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË PËR  
CAKTIMIN E NJË EKSPERTI KONTABËL TË AUTORIZUAR PËR TË  
VLERËSUAR PASURINË E MEDIA 6 SH.P.K.

Z. Frangaj morri fjalën dhe u shpjegoi ortakëve se në bazë të nenit 77 të ligjit 7638 date 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" kur një shoqëri e një forme tjetër shndërrohet në shoqëri anonime me kërkesë të drejtuesve të kësaj shoqërie i kërkohet gjykatës caktimi i një eksperti kontabël të autorizuar i cili do të vlerësojë nën përgjegjësinë e tij, pasurinë e kësaj shoqërie e cila do të përbëjë edhe aktivin e saj. Për këtë arsye pas një diskutimi të shkurtër ortakën në mënyrë unanime vendosën:


Ti drejtohen gjykatës me kërkesë për caktimin e Z. Iliriana Haxha në cilësinë eksperti kontabël i cili do të përgatisë raportin përkatës për gjendjen e shoqërisë pasurinë e saj, dhe kontributin e ortakëve në këtë shoqëri, për qitjen së kapitalit, duke respektuar kërkesat e nenit 168, 169 të ligjit "Për shoqëritë tregëtare".




Pas marrjes së vendimeve të mësipërme ortakët ranë dakort që të bëhet depozitimi i këtij vendimi pranë Zyrës së Rregjistrimit Tregëtar.

Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, mbledhja u mbyll.

**ORTAKËT**

  
Julien Roche

  
Marsel Skëndo

  
Aleksandër Frangaj